

Gjykata Supreme e Kosovës, kolegji i përberë nga gjyqtarët: Enver Peci, kryetar, Shukri Sylejmani dhe Emine Kaçiku, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Sherif Krasniqi, procesmbajtës, në kontestin administrativ të paditësit N.D., nga Prizreni, kundër të paditurës A.K.P në Prishtinë, lidhur me kërkesën e paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr.316/2015 datë 27.01.2016, në seancën e mbajtur më 28.04.2016, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e paditësit N.D., nga Prizreni, për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr. 316/2015, datë 27.01.2016.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës së Apelit të Kosovës, A.A.nr.316/2015 datë 27.01.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit N.D., nga Prizreni, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1324/2015, datë 15.10.2015.

Paditësi në afat ligjor i ka parashtrua kësaj Gjykate kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, me të cilën e konteston në tërësi ligjshmërinë e aktgjykimeve të përmendura më lart, me propozimin që të aprovet kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës së Apelit, AA.nr. AA.nr. 316/2015, datë 27.01.2016, dhe ai i Gjykatës Themelore Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1324/2015, datë 15.10.2015, të anulohen.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 53 të Ligjit për Konfliktet Administrative, ka mbajtur seancën e kolegjit dhe, pas vlerësimit të aktvendimit të atakuar dhe kërkesës së paditësit për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor si dhe shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, konstatoi:

Kërkesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, AA.nr. 316/2015, datë 27.01.2016, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative, A.nr.1324/2015, datë 15.10.2015, me të cilin është refuzuar kërkesëpadia e paditësit N.D., nga Prizreni, ushtruar kundër të së paditurës A.K.K. në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar anulimin e aktvendimit të Komunës së Prizrenit, nr.03/726/12, datë 08.10.2012.

Duke vendosur lidhur me kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të kontestuar, shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve në kërkesë, gjeti se gjykata e shkallës së dyte ka vepruar drejt kur ka refuzuar si të pabazuar ankesën e palës së paditur dhe ka vërtetuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Qëndrimin juridik të Gjykatës së Apelit, si të rregullt dhe të bazuar në ligj, në tërësi e aprovon edhe kjo Gjykatë, ngase aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje të së drejtës materiale dhe as të dispozitave procedurale, siç pretendon paditësi në kërkesë.

Sa u përket pretendimeve të paditësit se gjykatat e instancave më të ulëta kanë arritur në përfundimin e gabuar se paditësi nuk e ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për regjistrimin e paluajtshmerisë, duke konsideruar se ka pasur dokumentacion te nevojshëm dhe se pengesa që ka ekzistuar me masën e përkohshme është tërhequr. Këtë pretendim kjo Gjykatë e refuzon si të pabazuar dhe të paargumentuar, ngase në shkresat e lëndës nuk ekziston ndonjë provë me të cilën do të dëshmohej se është tërhequr masa e përkohshme e sigurimit e shqiptuar me vendimin e Gjykatës Komunale ne Prizren, C.nr.971/09, datë 24.05.2010. Nga neni 309 të Ligjit për Procedurën Kontestimore është parashikuar se masa e sigurimit, e caktuar me vendim të gjykatës, mbetet në fuqi derisa të mos jepet një vendim tjetër mbi këtë masë. Në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë me të cilën do të provohej që në çështjen civile që zhvillohet në Gjykatën Komunale Prizren të ketë ndonjë vendim për epilogun e kësaj procedure dhe që kontesti të ketë si bazë juridike nulitetin e kontratës së shitblerjes së paluajtshmerisë dhe dorëzimin e saj në posedim. Pretendimi i paditësit se masa e përkohshme e sigurisë ka të bëjë me ndalimin e kryerjes së çfarëdo punimeve në pjesën e ngastrës kontestuese nga ana e paditësit N.D. dhe ndërhyrësve të tjerë dhe se nuk paraqet pengesë për kalimin - regjistrim e kësaj paluajtshmerie, sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, është i pabazuar. Masa e përkohshme e sigurisë ndalon ndryshimin e gjendjes ekzistuese, kështu që me lejimin e regjistrimit të kësaj paluajtshmerie gjendja ekzistuese do të komplikohet edhe më tepër, duke pasur parasysh faktin se nuk kemi ndonjë vendim përfundimtar nga gjykata kompetente.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Supreme gjeti se gjykata e shkallës së parë dhe ajo e së dytës, me aktgjykimet e tyre ndaj kësaj çështjeje administrativo-juridike kane aplikuar drejt dispozitat e së drejtës administrative, Ligjit për Konfliktet Administrative, Ligjit për Procedurën Kontestimore, Ligjit për Themelimin e Regjistrimit të Drejtave të Pronës së Paluajtshme, kështu që pretendimet e paditësit të ngritura në kërkesën për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, janë të pabazuara, ngase nuk janë me ndikim në konstatimin e një gjendjeje faktike tjetër nga ajo që kanë vërtetuar gjykatat e instancave më të ulëta. Sipas vlerësimit të kësaj Gjykate, aktgjykimi i atakuar i shkallës së dytë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij janë dhënë arsye të nevojshëm mbi faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë. Gjykata vlerëson se edhe e drejta materiale është aplikuar drejt dhe se nuk është shkelur ligji në dëm të paditësit.

Nga si u tha me sipër, Gjykata Supreme e Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVES
Me 28 prill 2016, ARJ.nr.16/2016

Procesmbajtësi,
Sherif Krasniqi

Kryetari i kolegjit,
Enver Peci

